

A K T I I T H E M E L I M I T  
T E  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"N D R E U"

REPUBLIKA E SHQIPERISE

VITI NJEMIJE E NENTEQIND E NENTEDHJETE E PESE, ne Tirane,dt

ESHTE KONSTITUENTE :

PAULIN NDREU, lindur ne Qaf Mali Puke dhe banues ne Lezhe, i cili bie dakort qe te themeloje nje shoqeri private me pergjegjesi te kufizuar mbeshtetur ne dispozitat ligjore ne fuqi.

1. Shoqeria, e cila do te emertohet "Ndreu", dhe me poshte do te referohet si shoqeri, do te kete forme juridike te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar dhe aktiviteti i saj do te rregullohet nga normat e parashikuara ne kete akt, nga statuti i bashkangjitur dhe nga dispozitat ligjore ne fuqi per keto ceshtje.

2. Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj :Sherbimi i rojeve civile ne ruajtjen e objekteve ne pronesi ose ne perdorim te personave juridike e fizike shqiptare e te huaj, ruajtjen e rendin ne keto objekte dhe sigurimin e jetes se personelit e te vlerave pasurore te tyre gjate levizjeve, krahas kesaj do te kete dhe objekt: tregtim te makinerive e pajisjeve te tyre, shitje automjetesh, pjese kembimi per to, servis automjetesh si dhe karburante, lende druri , mallra te konsumit te gjere import eksport me shumice e pakice.

3. Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera me objekte te njejte te ngjashme ose te ndryshme me te vetin. Ajo ka te drejte te kryeje tegjitha operacionet tregtare, ekonomike, financiare qe lidhen me objektin kryesor te aktivitetit te saj e qe shihen te nevojshme ose me interes nga organi administrativ i shoqerise.

4. Selia e shoqerise do te caktohet ne Lezhe, prane Fabrikes se Miellit.

5.Kohezgjatja e shoqerise eshte caktuar mbi 10 vjet duke filluar nga data e rregjistrimit te saj prane regjistririt tregtar te Gjykates se rrethit Tirane.

6.Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke dhe derdhet teresisht nga ortaku i vetem,themelues i kesaj shoqerie.

7.Shoqeria do te administrohet nga nje Keshill Administrativ,anetaret e te cilit do te zgjidhen nga ortaku i vetem,me mandat te perseritshem.

Te gjitha shpenzimet e bera per themelimin e shoqerise,regjistrimin e saj dhe te cfaredo takse tjeter te detyrueshme sipas ligjit deri ne miratimin e bilancit te pare vjetor jane ne ngarkim te shoqerise.

8.Shoqeria do te rregullohet dhe me norma te tjera te percaktuara nga ligjet ne fuqi,duke zbatuar dispozitat urdheruese te ligjit nr.7638 dt 19.11.1992 dhe 7667 dt.28.1.1993 si dhe ligjit nr.7696 dt.7.4.1993 "Per sherbimin e rojeve civile".

9.Ky akt u redaktua ne 4 kopje autentike dhe pasi lexohet dhe gjendet sipas vullnetit te pales nenshkruhet prej tij rregullisht konform ligjit.

O R T A K U I V E T E M

PAULIN NDREU

*Paulin Ndreu*  
10/11/95

*Republika e Shqiperise*  
*Tirane*

*Cerrou 30.11.95*

*Nr. 1021, Rep*  
*M 301, Kol*

*Verketu*

*Vertetohet firma e Paulin Ndreut, lundra ne lunde e bannes ne legji, per identifikim e te ciles se kesaj nje dokumenti personal.*

*Prozer*  
*Holubaj*  
*HC*





# S T A T U T I

## I

### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### "N D R E U"

NGA: PAULIN NDREU ,lindur ne Qaf Mali Puke dhe banues ne Lezhe, eshte themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar duke perpunuar statutin si me poshte :

#### KREU I

#### FORMA, EMERTIMI I SHOQERISE, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

##### NENI 1

Nga pala nenshkruese e aktit te themelimit eshte krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me ligjet shqiptare ne fuqi dhe me dispozitat e ketij statuti.

##### NENI 2

Shoqeria merr emertimin "NDREU" sh.p.k dhe me poshte do te referohet si shoqeri.

##### NENI 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Sherbimi i rojeve civile per ruajtjen e objekteve ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike shqiptare dhe te huaj, ruajtje e rendit ne keto objekte dhe sigurimin e jetes se personelit e te vlerave pasurore te tyre gjate levizjes, si dhe veprimtari tregtare te makinerive e pajisjeve te tyre, shitje automjetesh, pjeseve te kembimit, servis automjetesh dhe karburante, lende druri mallra te konsumit te gjere, veprimtari Tregtare me shumice e pakice import eksport.

##### NENI 4

Selia e shoqerise eshte e caktuar ne qyettin e Lezhes,prane Fabrikes se Miellit.

Transferimi i selise se shoqerise ne nje adrese tjeter mund te behet me miratimin e ortakut te vetem.

#### NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise eshte caktuar mbi 10 vjet duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates.

Kohezgjatja mund te shtyhet ose te pakesohet(shkurtohet) ne rastet kur shoqeria do te prishet para kohe.

### KREU II

#### KAPITALI THEMELTAR

#### NENI 6

Kapitali thmeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.Ky kapital eshte tere-sisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetem.


Shoqeria mund ta shtojte ose pakesoje kapitalin e saj sipas vendimeve qe do te marre ortaku i vetem.

#### NENI 7

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve(nese do te kete te tille ne te ardhmen),gjithashtu ato mund ti transferohen dhe te treteve me miratimin e ortakut te vetem.Gjithashtu ato jane lirisht te transferueshme ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve si hde ne rruge trashegimie.Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial.

### KREU III

#### ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE



NENI 8

Ortaku eshte pergjegjes per humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin shoqeror.

Organi me i larte i drejtimit te shoqerise eshte ortaku i vetem.

Shoqeria mund te administrohet nga nje administrator i pergjithshem dhe nga nje keshill administrativ.

NENI 9

Anetaret e keshillit administrativ duhet te jene persona fizike ortake ose jo te shoqerise. Numri i tyre, paga dhe detyra e secilit caktohen nga ortaku i vetem dhe revokohen po nga ortaku i vetem ose largohen me deshire me mbarimin e afatit te kontraktuar, ose dhe para mbarimit te afatit por ne kete rast duhet te lajmeroje nje muaj me pare ortakun e vetem.

Keshilli administrativ kryhesohet nga ortaku i vetem ose nga persona te autorizuar prej tij.

NENI 10

Ortaku i vetem si i vetmi organ sovran i shoqerise vendos per ceshtje te tilla si: emerimin apo revokimin e administratoreve, te eksperteve kontabel te autorizuar, te likuidatoreve, aprovimin e raporteve te administrimit, te bilancit vjetor, ndryshimet qe mund ti behen statutit, shtimin ose pakesimin e kapitaleve te shoqerise, transferimin e nje pjese te kapitalit te nje i trete, shtytjen e kohezgjatjes se shoqerise apo vendos per likuidimin e saj, nderrimin e formes juridike te shoqerise nga SH.P.K, ne nje forme tjeter, etj.

Per sa i perket rojeve civile percakton numrin e tyre dhe ua dergon per miratim organeve perkatese te rendit publik.

NENI 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatimte te plote te normave qe permban



ky statut,akti i themelimit si she ato te legjislacionit ne fuqi.Ajo fiton zotesine per te vepruar me marrjen e miratimit nga drejtoria e pergjithshme e policise persa i perket rojeve civile,me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar te Gjykates ndersa e ushtron aktivitetin e saj ekonomik me regjistrimin si subjekt privat prane zyrave te rajonit perkates te sektorit te tatim taksave.Shoqeria ka vulen e saj me madhesi normale dhe permbajtjen per-rreth,ne gjuhen shqipe si dhe ka llogari,likuiduse ne Banke.

NENI 12

Shoqeria vepron ne regjimin e prones private,parimeve te llogarise ekonomike te tregut,me qellim kryesor fitimin.Ajo posedon pasuri te saj dhe ka te drejten e perdorimit te kesaj pasurie,te kredive te ndryshme qe merr afat gjata dhe afat shkurtera,kontraktiveve,sipas qellimeve dhe objektiveve te veprimtarive qe ka parashikuar te zbatoje.Shoqeria gezon te drejten te mbroje pasurine e saj private sipas kushtetutes dhe ligjeve shqiptare.

Shoqeria merr persiper te drejta dhe detyrime kontraktore dhe jashte kontraktore brenda kapitalit themelor te saj.Ortaku i vetem nuk pergjigjet per keto detyrime me pasuri te tij te fituara ne aktivitete te tjera ekonomike jashte kesaj shoqerie.

NENI 13

Shoqeria merr vendime ne zbatim te plote te ligjeve ne fuqi dhe te ketij statuti te cilat jane te detyrueshme per zbatim nga te gjitha te punesuarit ne kete shoqeri.

Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillim te shoqerise bazuar dhe ne rregulloret e brendeshme te shoqerise ajo puneson punetore dhe emron administratore te cilet qendrojne ne detyre derisa revokohen nga shoqeria ose largohen vete me deshire.Administratoret e emruar i kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne

emer te shoqerise me perjashtim te rastit kur keto kompetenca jane caktuar shprehimisht ortakut te vetem. Ne kete rast shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve dhe administratori pergjigjet ne menyre individuale. Administratori i pergjithshem si dhe ai i autorizuar prej tij me akt delegimi te shkruar eshte i veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te drejtitimit te shoqerise duke kryer cdo veprim qe e quan me interes per shoqerine si dhe duke perforcuar shoqerine prane cdo organi apo institucioni ai dhe ne organet gjyqesore.

#### KREU IV

#### MARREDHENIET PER PUNESIM

#### NENI 14

Kriteret e pergjithshme te punesimit te personave te tjere, numrin e tyre, kufijte e pageses dhe detyrat e sejcilit ne shoqeri percaktohen nga ortaku i vetem.

Persa i perket rojeve civile, numri i efektivit te tyre percaktohen ne marreveshje me organet e rendit publik por gjithnje me pak se % e gjithe efektivit te policise se rendit te njesise administrative ku veprom! Rojet civile perzgjidhen nga shoqeris dhe keto i kalohen per miratim organeve te rendit publik per dhenien e licences se ushtrimit te profesionib! Te gjithe te punesuarit jane te detyruar ti nenshtrohen regjimit juridik te normave te statutit, regullores se brendeshme, si dhe ligjit nr. 7696 dt. 7.4.1993 dhe V.K.M. nr. 210 dt 10.5.1993 "Per sherbimin e rojeve civile". Punesimi ne shoqeri i rojeve civile behet sipas ligjit ne fuqi dhe per te gjithe ata qe plotesojne kerkesat e nenit 5 te vendimit te Keshillit te Ministrave. Punesimi i personave behet mbi bazen e kontrates kolektive ose individuale te punes. Shoqeria merr persiper te respektoje te gjithe rregullat ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore per te gjithe te punesuarit ne te.

Te gjithë te punësuarit në shoqëri përgjigjen sipas ligjeve dhe sipas këtij statuti për mos zbatim të detyrave dhe për demet që i shkaktojnë shoqërisë. Administratoret mbajnë përgjegjësi civile e penale në kryerjen e detyrave të tyre. Rojet civile dhe punonjësit e emruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimeve që realizon shoqëria gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

NENI 15

Administratoret e emruar apo të deleguar nuk marrin çilesinë e ortakut në shoqëri dhe nuk i lejohet të ushtroje asnjë aktivitet konkurrues me të të çfarëdo lloji për llogari të tij apo të tjetërve përveç atyre të autorizuara nga administratori i përgjithshëm. Për çdo shkelje në këtë drejtim administratori largohet nga shoqëria dhe përgjigjet për demet e shkaktuara asaj.

KREU V

KONFIDENCIALITETI

NENI 16

Ortaku vetë dhe për personat e pranuar në shoqëri bie dakort që të mos i ekspozojë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 17

Të gjitha aktet dhe dokumentat e tjera që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tjetër duhet të tregojnë lexueshëm emrin e shoqërisë dhe pas saj fjalet SH.P.K, emrin e administratorit, kapitalin themeltar etj.

NENI 18

Shoqëria do ta konsiderojë qendrën e vet në Lezhë si shoqëri Nene, e cila rast pas rasti do të hapet edhe në filiale të tjera ose shoqëri të përbashkëta në të gjithë ato vende ku do të shikojë interes në përmbushjen e qëllimeve të saj.



ersa i perket sherbimit te rojeve civile shoqeria vepron ne njesi te caktuara administrative territoriale dhe pikerisht ne rrethin e Lezhes.

#### KONTROLLI I BRENDSEM

##### NENI 19

Shoqeria organizon kontrollin e brendshem me nje ose me shume eksperte kontabel te autorizuar. Eksperti kontabel zbaton dhe kontrollon zbatimin e ligjshmerise se statutit dhe garanton qe llogarite dhe inventaret vjetore te pasurise se shoqerise jane hartuar drejt dhe japin nje pasqyrim te sakte te rezultateve te operacioneve te vitit te kaluar financiar, te gjendjes financiare e te trashigimise se shoqerise ne fundin e vitit. Ai eshte pergjegjes para shoqerise dhe te treteve per pasojat qe rrjedhin nga fajet e nenvleftesimet e tij ne ushtrimin e funksioneve dhe vleresimet e dhena.

#### BILANCI DHE TE ARDHURAT

##### NENI 20

Veprimet ekonomike dhe financiare te shoqerise fillojne ne 1 Janar dhe mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti perjashtimisht viti i pare financiar mbyllet ne 31 Dhjetor te vitit 1995, pervec rasteve dhe urdhrave te vecanta qe jep administratori i pergjithshem. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore administratori i ngarkuar nxjerr bilancin kontabel te shoqerise me rezultatin ekonomik fitim humbje, inventare e raporte perkatese sipas ligjeve, rregullave dhe dokumentacionit baze te miratuar. Bilanci kontabel miratohet nga ortakut i vetem brenda 31 Marsit te vitit pasues. Me miratimin e bilancit kontabel vjetor shoqeria vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme si fondin e akumulimit, fondin rezerve, etj. Per rezerva financiare caktohet 5 % fitimit vjetor deri sa ky fond te arrije sa 10 % i fondit themeltar te shoqerise. Pas ketij niveli kuota e rezervimit vjetor eshte e lire.

NENI 21

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve si me siper dhe shlyerjes se detyrimeve fiskale, shlyerjes se detyrimeve kontraktore me te tretet, shlyerjes se pagave te punonjesve dhe detyrimeve te sigurimeve shoqerore i mbesin per perdorim ortakut te vetem te shoqerise.

Te gjitha keto shpenzime si dhe ato mbajtjes se keshillit administrativv perballohen nga shoqeria.

NENI 22

Per te precizuar dhe per te saketesuar veprimtarine e vet, marredheniet e punes dhe aktivitetin financiar shoqeria do te cele librin e vet i cili quhet LIBRI I SHOQERISE, krahas librave te caktuara kontabel.

Perfaqesimi i shoqerise me te tretet, ne organet gjyqesore dhe administrative i perket ortakut te vetem si dhe personave te autorizuar prej tij me akt delegimi te shkruar.

KREU VI

SHPERBERJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

NENI 23

Shoqeria prishet me perfundimin e afatit te caktuar pra me kalimin e 10 vjeteve me perjashtim te rastit kur behet zgjatja e afatit te ketij kufiri me miratimin e ortakut te vetem ose kur ka nje prishje te parakoheshme per arsyet e parashikuara ne ligj.

NENI 24

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi ortakut cakton nje ose disa likuidues te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivit te shoqerise mbi ndjekjen e opracioneve te likuidimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likuidimit ortakut vendos per bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit the

Themeltar tek kontribuesit perkates (nese do te kete te tille) likuiduesi ndan kapitalin per ortakun e vetem i cili ka investuar teresisht kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 25

Per sa i perket rojeve civile, marrehdaniet me komisariatin e policise si dhe me personat fizike e juridike privat dhe shteteror do te rregullohen vetem nepermjet kontratave perkatese.

Per aftesimin profesional te punonjsve shoqeria do te bashkerendoje punen me komisariatin e policise te rrethit Lezhe.

Neni 26

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te linden gjate ekzistences te shoqerise ose gjate likuidimit te saj, midis shoqerise dhe te treteve si dhe midis saj dhe te punesuarëve do te tentohen te zgjidhen me mirekuptim ne rast te kundert ato do ti drejtohen per zgjidhje gjykates kompetente shqiptare.

Per sa nuk eshte shprehur ne kete akt do ti referohet dispozitave perkatese per shoqerite tregtare ligjit Nr.7638, Nr.7667 si dhe ligjit per rojet civile Nr.7696 dhe vendimit te Keshillit te Ministrave date 10.5.1993, Nr.210, dhe plotesimeve te metejshme te tyre.

Neni 27

Ky akt u redaktua ne kater kopje autentike. Per cdo ndryshim, shtese apo shkurtim te aktivitetit, si dhe ndryshim tjeter do te behet me te njejten procedure ne te cilen behet dhe vete nxjerrja e ketij statuti. Ndryshimet dhe plotesimet nuk prekin personalitetin juridik te shoqerise.

Akti pasi u lexua nga pala dhe u gjet sipas vullnetit te tij nenshkruhet rregullisht sipas ligjit.

O R T A K U I V E T E M

PAULIN NDREU

